



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 88

Tiranë – E martë, 25 prill 2017

## PËRMBAJTJA

|  | Faqe  |
|--|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 331, datë 12.4.2017 | Për miratimin e tarifës së mirëmbajtjes së sistemit qendror të monitorimit <i>on-line</i> (SQMO) që duhet të paguajnë shoqëritë e licencuara 5127   |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 337, datë 19.4.2017 | Për një ndryshim në vendimin nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 5127  |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.4.2017 | Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te bashkia Finiq, të pronës nr.646, me emërtim “Ish-grup artileri tokësore”, me vendndodhje në Krane, Finiq, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar..... 5128 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 339, datë 19.4.2017 | Për disa ndryshime në vendimin nr.728, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin e NATO-S “AEGEAN SEA””..... 5130   |



## VENDIM

Nr. 331, datë 12.4.2017

**PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË  
MIRËMBAJTJES SË SISTEMIT  
QENDROR TË MONITORIMIT *ON-LINE*  
(SQMO) QË DUHET TË PAGUAJNË  
SHOQËRITË E LICENCUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 48, pika 2, 70, pika 12, të ligjit nr.155, datë 21.12.2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 3, të kreut VI, të vendimit nr.647 datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës dhe kriterëve të përzgjedhjes të operatorit që do të ndërtojë Sistemin Qendror të Monitorimit *On-line* (SQMO) si dhe autoritetin përgjegjës për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

## LIDHJA 1

| Kategoria            | Tarifa e mirëmbajtjes   |  |
|----------------------|---|--|
| “Baste sportive”     | Tarifa ditore prej 0.70 euro pa TVSH për çdo njësi, ku njësia është çdo qendër basti          | Tarifa me përqindje mbi xhiron vjetore që faturon organizatori: 0,5% ose (0,005) |
| “Lotaria Kombëtare”  | Tarifa ditore prej 1.00 euro pa TVSH për çdo njësi, ku njësia është çdo operator              | Tarifa me përqindje mbi xhiron vjetore që faturon organizatori: 0.0% (ose 0.000) |
| “Kazino elektronike” | Tarifa ditore prej 1.25 euro pa TVSH për çdo njësi, ku njësia është çdo aparaturë elektronike | Tarifa me përqindje mbi xhiron vjetore që faturon organizatori: 0.0% (ose 0.000) |

## VENDIM

Nr. 337, datë 19.4.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN  
NR.718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E  
PERSONAVE TË SHPALLUR SI  
FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit, sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit

## VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së mirëmbajtjes së Sistemit Qendror të Monitorimit *On-line*, që duhet të paguajnë shoqëritë e licencuara, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ministri i Financave vazhdon procedurën për lidhjen e kontratës me shoqërinë e shpallur fituese, sipas kushteve teknike, afateve të implementimit të projektit të përcaktuara në ofertën e shpallur fituese.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

**Niko Peleshi**

(“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”, çregjistrohet individi i renditur në shkronjën “a”, sipas ndryshimit bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

**Niko Peleshi**



**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE  
TË SHPALLUR SI FINANCUES TË  
TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË  
SIGURIMIT

(“LISTA E OKB-së”)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE  
BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN  
ISIL (Da’esh) dhe AL-QAIDA

a) Lista e ndryshuar në “Lista e individëve  
anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën ISIL  
(Da’esh) dhe AL-Qaida”;

1. KHADAFI; ABUBAKAR; JANJALANI

Shënim: Gjenealitetet e tjera për personin, emri i  
të cilit është renditur më sipër, mbahen në  
Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të  
Pastrimit të Parave.

**VENDIM**

**Nr. 338, datë 19.4.2017**

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA  
MINISTRIA E MBROJTJESTE BASHKIA  
FINIQ, TË PRONËS NR.646, ME  
EMËRTIM “ISH-GRUP ARTILERI  
TOKËSORE”, ME VENDNDODHJE NË  
KRANE, FINIQ, DHE PËR NJË  
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515,  
DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E  
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE  
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË  
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI  
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË  
MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të  
neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001,  
“Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar,  
dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr.8744, datë

22.2.2001, “Për transferimin e pronave të  
paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes  
vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit  
të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes  
te Bashkia Finiq, të pronës nr.646, me emërtim  
“Ish-grup artileri tokësore”, me vendndodhje në  
Krane, Finiq, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet  
këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta  
përdorur për ndërtimin e një qendre të shërbimeve  
publike dhe për vendosjen e shërbimit zjarrfikës,  
MZSH, për realizimin e funksioneve të veta e të  
shërbimeve në territorin që përfshin Bashkia Finiq.

2. Në listën e inventarit të pronave të  
paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit  
nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të  
ndryshuar, të hiqet prona nr.646, me emërtim  
“Ish-grup artileri tokësore”, me vendndodhje në Krane,  
Finiq, dhe të shtohet në listën e inventarit të  
pronave paluajtshme shtetërore publike, që i kanë  
kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Finiq.

3. Bashkisë Finiq i ndalohet të ndryshojë  
destinacionin e përdorimit të pronës nr.646, me  
emërtim “Ish-grup artileri tokësore”, me  
vendndodhje në Krane, Finiq, të përcaktuar në  
pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua  
japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e  
Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të  
Paluajtshme, kryeregjistruesi i Pasurive të  
Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe  
Bashkia Finiq për ndjekjen dhe zbatimin e këtij  
vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren  
Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Niko Peleshi**




PLAN RILEVIMI  
 Prona nr.646 REP. USHT. GR.AT. KRANE DELVINE

IDENTIFIKIMI I PASURISE

Zona Kadastrale 2264  
 Nr.Pasurise Vol. Fq  
 Indeksi i Hartes J-34-5-(67-D) ,(83-B)  
 Shkalla 1 : 2500  
 Adresa e pasurise DELVINE  
 Q/F KRANE DELVINE  
 Pronari :  
 Ministria e Mbrojtjes,Komanda Mbështetëse

Nentor 2016



Shpjeguese:  
 Sip e perqijthshme=20007 m2  
 Siperfaqe ndertimi=2370.35m2  
 — Kufiri i Repartit

**Shënimi :** Ky planrilevimi u hartua në zbatim të shkresës së Komandës Mbështetëse nr.6115, datë 07/09/2016, bazuar në kufijtë faktik të pronës të trenguar nga përfaqësuesi i K.M, hedhur mbi orlofon dhe kuadrin e bashkimit të HTR të dhënë nga ZQRPP, Tiranë.

**VENDIM****Nr. 339, datë 19.4.2017****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.728, DATË 20.10.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E NATO-S “AEGEAN SEA””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, dhe 7, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.728, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në fund të pikës 1, shtohen fjalët “... si dhe 1 (një) ushtarak oficer shtabi, në Grupin Detar të Përherhëm të NATO-s, në anijen flamurtare”.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë:

“3. Kohëzgjatja e pjesëmarrjes në këtë operacion për personelin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është, si më poshtë vijon:

a) Për 21 (njëzet e një) ushtarakët dhe anijen e klasit “Iliria”, deri në 30 nëntor 2017, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit është çdo 2 (dy) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës.

b) Për ushtarakun oficer shtabi, në Grupin Detar të Përherhëm të NATO-s, në anijen flamurtare, deri në 31 dhjetor 2017, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit është çdo 3 (tre) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me përfaqësuesin e radhës.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI****Niko Peleshi**

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 56 lekë